



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Mbledhja nr. **06/2025**

Data: **15 janar, 2025. Ora: 14:30**

Vendi: **Selia e KQZ**

Kryesues i KQZ-së: Kreshnik Radoniqi.

Anëtarët e KQZ-së: Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Sami Hamiti,
Alban Krasniqi, Ibrahim Selmanaj, Fazli Stollaj, Gordana Llaban, Qemailj

Në takim ishin të Kurtis, Mufera Shinik

pranishëm:

U.D. Drejtori i SKQZ dhe Drejtor i ZRCKFSP: Besnik Buzhala

Përkthyes: Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr. 02 dhe 03/2025

3. Këshillat e KQZ

3.1. Këshilli për Operacione Zgjedhore

-
- 3.1.1. Shqyrtimi dhe miratimi i numerit të fletëvotimeve dhe broshurave që shtypen, zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09 shkurt 2025
 - 3.1.2. Shqyrtimi dhe miratimi i numrit shtesë të vendvotimeve në qendrat e votimit në përfaqësitë diplomatike në Bernë dhe Gjenevë
 - 3.1.3. Shqyrtimi dhe miratimi i ekipeve të autorizuara për tërheqjen e dërgesave postare jashtë Kosovës
 - 3.1.4. Shqyrtimi dhe miratimi i procedurave të votimit dhe numërimit në vendvotim
 - 3.1.5. Shqyrtimi dhe miratimi i udhëzuesit të pranim dorëzimit
 - 3.1.6. Shqyrtimi dhe miratimi i procedurave për QKN
 - 3.1.7. Shqyrtimi dhe miratimi i procedurave për VPNV
 - 3.1.8. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit operacional të sigurisë për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09 shkurt 2025, që përfshinë shtatë (7) shtojca
 - 3.1.9. Diskutim për QKN dhe QV

4. Të ndryshme

1.Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Kreshnik Radoniqi, kryesues i mbledhjes nr. 6 të KQZ-së, pasqyroi agjendën e takimit. **Arianit Elshani**, propozoi pikat: “Shqyrtimi dhe miratimi i udhëzuesit të pranim dorëzimit” Shqyrtimi dhe miratimi i procedurave për QKN”, “Shqyrtimi dhe miratimi i procedurave për VPNV” dhe “Diskutim për QKN dhe QV” të largohen nga rendi i ditës. Në kontekst, të shtohen pikat: “Vizitat për kutitë postare jashtë vendit”, dhe “Mbikëqyrja e fletëvotimeve” që është ligjore. Pra, të parashihet edhe buxheti për këto dy aktivitete. Edhe një rekomandim: “Shtyrja e afatit për vëzhguesit e partive politike”.

Me këto ndryshime, me 10 vota për, u miratua rendi i ditës. Në vazhdim, po ashtu me 9 vota për dhe 1 abstenim, u miratuan procesverbalet nga mbledhjet nr. 02 dhe 03/2025 të KQZ-së.

2.Këshillat e KQZ

Këshilli për Operacione Zgjedhore

1. Shqyrtimi dhe miratimi i numrit të fletëvotimeve dhe broshurave që shtypen, zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09 shkurt 2025:

Arianit Elshani: KOZ-i, ka shqyrtuar numrin e fletëvotimeve dhe të broshurave që shtypen, zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09 shkurt 2025. Këto produkte, kësaj here prodhohen nga një operator. Numri në total i fletëvotimeve, është 1, 752, 650 fletëvotime. Broshurat kandidatëve: 16, 980 copë. Dhe, janë 2, 635 lista votuese: në vendvotimet e rregullta, të vendvotime me kusht, dhe ato që dërgohen në përfaqësitë diplomatike.

Me 10 vota për miratohet ky rekomandim i KOZ-it.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i numrit shtesë të vendvotimeve në qendrat e votimit në përfaqësitë diplomatike në Bernë dhe Gjenevë:

Arianit Elshani: E kemi diskutuar edhe më parë mundësinë-nevojën e hapjes së numrit shtesë të vendvotimeve në qendrat e votimit në përfaqësitë diplomatike. Tani, bëhet fjalë për hapjen e tyre në Bernë dhe në Gjenevë. Kemi diskutuar, sepse ka mundësi objektive. Prandaj, bëhet fjalë për një vendvotim shtesë në Gjenevë dhe një në Bernë. Ndërsa në Stokholm kishim para parë 2 vendvotime, por tani duhet ta shndërrojmë vetëm në një vendvotim sepse, kemi vetëm 271 persona që do të votojnë fizikisht. Duhet bashkëpunuar edhe me subjektet politike lidhur me komisionarët.

Sami Kurteshi, tha se sa di unë, në Gjenevë do jetë pak vështirë sepse, a do të ketë hapësirë...!

Arianit Elshani, tha se kemi diskutuar dhe do ta kemi një situacion – informacion se si do të rregullohen këto dy vendvotime të reja shtesë.

Me 10 vota për miratohet ky rekomandim i KOZ-it.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i ekipeve të autorizuara për tërheqjen e dërgesave postare jashtë Kosovës:

Arianit Elshani: Kemi shqyrtuar edhe këtë pikë lidhur me listën e stafit të MPJ-së të cilët duhet të autorizohen që ata ti menaxhojnë dërgesat postare drejt operatorit të kontraktuar nga KQZ, dhe pastaj

dërgesat të sillen në Kosovë. Ne, kemi vendosur kriteret e tona: 2 persona ku ka më pak kuti, ndërsa për Shtutgard dhe Cyrih, do kemi nga 4 zyrtarë të autorizuar. Por, gjatë gjithë kohës procesi do të jetë i mbikëqyrur, i evidentuar dhe siguruar sipas kriterëve, të dërgohen edhe raportet në KQZ. Gjatë kësaj kohe, do jenë edhe vëzhguesit e partive politike, por nëse ka të akredituar vëzhgues në KQZ, edhe ata do të jenë prezent...

Do të krijohen edhe formularët, por do të organizohet edhe një trajnim për personelin që do merret me këtë proces.

Në këtë pikë, shtruan pyetje dhe diskutuan: Sami Kurteshi, Ilir Gashi, cili tha se operatori mirë kish qenë në baza ditore ta nisë materialin për në Kosovë.

Me 10 vota për miratohet ky rekomandim i KOZ-it.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i procedurave të votimit dhe numërimit në vendvotim:

Arianit Elshani: E kemi shqyrtuar edhe këtë pikë të procedurave të votimit dhe numërimit në vendvotim. Doracaku, është përditësuar me të gjitha të dhënat e parapara në rregullore dhe në ndryshimet ligjore. E kemi trajtuar dy herë, e madje edhe sot. Ky dokument, plotëson nevojat dhe përmbajtjet e duhura. Ne, rekomandojmë të miratohet dhe të vazhdohet me procedurat tjera...

Me 10 vota për miratohet ky rekomandim i KOZ-it.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit operacional të sigurisë për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09 shkurt 2025, që përfshinë shtatë (7) shtojca:

Arianit Elshani, paraqiti planin e sigurisë, ku parashihen edhe masat që kanë të bëjnë me sigurinë kibernetike. Po ashtu, janë parapa relacionet e kontakteve me institucionet e sigurisë në vend. Pra, do të kemi koordinim nacional dhe në dimension lokal.

Diskutuan: Sami Kurteshi dhe Alban Krasniqi.

Me 10 vota për miratohet ky rekomandim i KOZ-it.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i vizitës nga KQZ në Shtutgard dhe Cyrih lidhur me hapjen e vendvotimeve shtesë në këto dy qytete për votim jashtë vendit:

Arianit Elshani: Gjatë diskutimeve ka dalë konkludimi që përgjatë shtimit të vendotimeve të reja në Shtutgard dhe Cyrih, e ku janë 64, 000 votues potencial, të vizitohen këto qendra votimi. Ne, duhet të sigurohemi në proces... Rekomandojmë dy emra: Arianit Elshani dhe Alban Krasniqi. Mbetet që edhe nga Sekretariati, të autorizohet dikush.

Alban Krasniqi, propozoi që të autorizohet drejtori i SKQZ që, edhe në rastet tjera, dhe për çdo rast nëse paraqitet nevoja, të udhëtojnë jashtë zyrtarët e sekretariatit dhe të mbikëqyrin procesin. Ibrahim Selmanaj, tha se po, për së afërmi ti mbikëqyrin procedurat, sigurinë etj. Sami Kurteshi, tha se ditëve të fundit ka dyshime. Unë, bëj thirrje që bashkatdhetarët të votojnë në kutitë postare që i ka nominuar KQZ. Kjo është adresa, kutitë postare të KQZ-së...

Me 10 vota për, Arianit Elshani dhe Alban Krasniqi, dhe një zyrtar nga Sekretariati, udhëtojnë në Shtutgard dhe Cyrih.

7. Shqyrtimi dhe miratimi i mbikëqyrjes nga Sekretariati të shtypjes së fletëvotimeve në Republikën e Sllovenisë:

Arianit Elshani, tha se ashtu si edhe në të kaluarën, do të bëhet edhe mbikëqyrja – vëzhgimi i shtypjes së materialit: fletëvotimet, broshurave dhe listës votuese. Në kontekst, si rekomandim, ne propozojmë që: kryetari Kreshnik Radoniqi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Alban Krasniqi, Sami Kurteshi, Ibrahim Selmanaj dhe Myfera Shinik si pjesë e KQZ-së, bashkë me zyrtarët e sekretariatit të jenë pjesë e ekipit. Për datat e udhëtimit, njoftimi bëhet nga sekretariati...

Me 10 vota për, miratohet ky rekomandim.

8. Shqyrtimi dhe miratimi i zgjatjes së afatit për akreditim të vëzhguesëve të subjekteve politike:

Arianit Elshani: E kemi shqyrtuar edhe këtë pikë, pavarësisht planin operacional. Kishim 6 ditë vonëse në dhjetor. Dhe ne rekomandojmë që ky afat të shtyhet deri më datën 20 janar.

Ibrahim Selmanaj: Shtyrja e këtij afati, nuk e cenon planin operacional...

Besnik Buzhala, e informoi KQZ-në se shtyrja e këtij afati, nuk interferon në aktivitetin e Sekretariatit dhe Zyres.

Me 8 vota për, dhe 2 vota kundër, u miratua ky rekomandim.

3.Të ndyshme !

Sami Kurteshi, tha se ne e përcjellim fushatën, dhe ka probleme. Sidomos jashtë, si bie fjala fotografimi i votës! Krejt arsyet janë që, kushdo qoftë, të paraqitet në PZAP me emër e mbiemër kushdo qoftë, dhe ata persona të sanksionohen. Kjo, është e ndaluar, është vepër e ndaluar, kudo qoftë. Vota është e fshehtë dhe personale...

Qemailj Kurtis: Pajtohem me propozimin e kolegut: po, reklamimi i votës është i ndaluar. Edhe çështje: të mos vonohen mjetet që u takojnë partive politike, mjetet e tyre të procedohen...